

VENDIM
Nr. 597, datë 18.10.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 348,
DATË 9.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E
HYRJES/DALJES, VULOSJES SË ARMËVE DHE REGJISTRIMIT TË SHTETASVE
SHQIPTARË E TË HUAJ ME ARMË TË KATEGORIVE “B” E “C”, NË
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 9, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 348, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorive “B” e “C”, në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, “Regjimi për hyrjet/daljet dhe regjistrimin e armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) certifikatën e çaktivizimit për armët e çaktivizuara.”.

b) Në pikën 4, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) certifikatën e çaktivizimit për armët e çaktivizuara.”.

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në rastet kur punonjësi i policisë kufitare, gjatë kontrollit fizik, gjen armë, pjesë të armëve dhe municion, të cilat subjekti i licencuar, person fizik ose juridik, nuk i ka në inventarin shoqërues të autorizimit të importit ose nuk përfshihen në objektin e licencës për veprimtarinë e lejuar me armë, ose kanë numra të ndryshëm serialë nga ato në autorizim, apo konstaton se arma/armët dhe pjesët kryesore të tyre nuk shoqërohen me certifikatën e çaktivizimit, markimi i çaktivizimit mungon apo nuk përputhet me certifikatën e çaktivizimit, punonjësi i policisë/doganës duhet të sekuestrojë armën dhe municionin, pas kryerjes së veprimeve procedurale penale. Ai njofton vendin e eksportit/importit, që të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të ndryshojë autorizimin, duke përditësuar inventarin shoqërues ose të tërheqë armën, pjesën e armës ose municionin që nuk është në inventarin fizik shoqërues, pas kryerjes së veprimeve procedurale penale në shtetin e origjinës ose shtetet, ku kanë kaluar tranzit.”.

2. Në kreun II, “Procedurat e markimit të armëve të zjarrit”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 15 shfuqizohet;

b) Pika 17 shfuqizohet.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku